

URDHËR

Nr.666, datë 03.08.2009

PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TEKNIKE DHE KRITEREVE TË SIGURISË, TË PËRKOHSHME, PËR KËRKESAT MINIMALE TË PROJEKTIMIT TEKNIK, NDËRTIMIT DHE OPERIMIT TË SISTEMEVE TË TRANSMETIMIT E TË SHPËRNDARJES SË GAZIT NATYROR, TË INSTALIMEVE TË GNL-SË, HAPËSIRAVE TË DEPOZITIMIT DHE TË LINJAVE DIREKTE

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 7 të ligjit nr.9946, datë 30.6.2008 “Për sektorin e gazit natyror”,

URDHËROJ:

1. Për operimin e sigurt të sistemeve të gazit natyror, kërkesat minimale të projektimit teknik, ndërtimit dhe operimit të sistemeve të transmetimit e të shpërndarjes së gazit natyror, të instalimeve të GNL-së, të hapësirave të depozitimit dhe të linjave direkte, do të bazohen në rregullat dhe kriteret e sigurisë që janë në fuqi në Itali dhe/ose Greqi.
2. Çdo subjekt i interesuar për ndërtimin dhe operimin e sistemeve të gazit natyror dhe që do të paraqesë për miratim një projekt teknik të sistemeve të transmetimit e të shpërndarjes së gazit natyror, të instalimeve të GNL-së, të hapësirave të depozitimit dhe të linjave direkte, është i detyruar që të prezantojë edhe se cilat do të jenë rregullat teknike dhe kriteret e sigurisë që do të zbatohen gjatë projektimit teknik, ndërtimit dhe operimit të sistemeve të gazit natyror.
3. Strukturat përgjegjëse për sektorin hidrokarbur në ministri, mund të kërkojnë marrjen e opinionit dhe vlerësimit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë për propozimin e paraqitur nga subjekti i interesuar, lidhur me rregullat teknike dhe kriteret e sigurisë që do të zbatohet ky subjekt gjatë projektimit teknik, ndërtimit dhe operimit të sistemeve të gazit natyror.
4. Rregullat dhe kriteret e sigurisë të përcaktuara në pikën 1 të këtij urdhri do të zbatohen deri në miratimin e rregullave teknike dhe kriterëve të sigurisë nga Këshilli i Ministrave siç parashikohet nga pika 1 e nenit 7 të ligjit nr.9946, datë 30.6.2008 “Për sektorin e gazit natyror”.

5. Operimi i infrastrukturës ekzistuese të gazit natyror do të jetë objekt i rregullave teknike dhe kritereve të sigurisë që kanë qenë në fuqi në Republikën e Shqipërisë para daljes së këtij vendimi.

6. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen strukturat përgjegjëse për sektorin hidrokarbur në ministri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERJËTIKËS

Genc Ruli